

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëria Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft me seli në adresën Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani, e dorëzuar përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 26.10.2022, solli

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft me seli të regjistruar në Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani do të fitoj kontroll të pavarur mbi RejsDipartment B.V. me seli të regjistruar në Lange Grafte 9, 7321 Apeldoorn, Holandë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 20.09.2022, i plotësuar më 29.09.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft me seli të regjistruar në Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft do të fitoj kontroll të pavarur mbi RejsDipartment B.V. me seli të regjistruar në Lange Grafte 9, 7321 Apeldoorn, Holandë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve përfshirëse:

- **Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft** është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë. Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft është një prodhues gjerman i automobilave i specializuar në dizajn, prodhim dhe distribuim të makinave sportive me performancë të lartë, SUV-ve. Selia e Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft gjindet në Shtuttgart, Gjermani. Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciengezellshaft është një shoqëri e kontrolluar në mënyrë indirekte në pronësi të plotë të Folksvagen Akciengezellshaft. Folksvagen është një kompani e tregtuar publike me seli në Wolfsburg, (Gjermani), e cila është shoqëria mëmë e Grupit Folksvagen.

Grupi Folksvagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, maketingun dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit, shasive të autobusëve dhe motorëve me naftë, motoçikletave, duke përfshirë pjesë rezervë dhe pajisje plotësuese për të gjitha kategoritë e specifikuara të automjeteve. Folksvagen Akciengezellshaft përfshin markat e automjeteve Folksvagen Pesinxher Kars, Folksvagen Lajt Komershal, Audi, Shkoda, Lamborxhini, SEAT, MAN, Skania dhe Dukati. Grupi Folksvagen ofron gjithashtu zgjidhje për shërbimet e lëvizshmërisë si automjetet në thirrje dhe ndarja e automjeteve.

Përveç kësaj, Grupi Folksvagen ofron shërbime financiare të sigurimit në lidhje me distribuimin dhe financimin e makinave dhe automjeteve komerciale të tij. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes Folksvagen Fajnenshnal Servisis AG dhe shoqërive të varura të tij.

Grupi Folksvagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

-Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me veprimtari bazë të regjistruar – lizing financiar;

-Porshe Broker SHA Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me veprimtari bazë të regjistruar - veprimtari të agjentëve të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;

-Skania Makedonia SHPKNJP Ilinden, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe me veprimtari kryesore të regjistruar - tregti me mjete të tjera motorike dhe

-Porshe Makedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 4, Shkup dhe me veprimtari kryesore të regjistruar - tregti me vetura dhe mjete motorike të kategorisë së lehtë.

Veprimtaria prioritare e shoqërive të përmendura në Maqedoninë e Veriut është tregtia me automjete dhe lizingut financiar.

-**Rejsdipartment B.V.** është përgjithësisht aktiv me shitjen e hapësirës së reklamimit dhe marketingut online në internet/faqet e internetit, shërbimet e publicitetit dhe përdorimit, duke u fokusuar në lajmet (me pagesë) dhe përmbajtjen mediatike në lidhje me sportet motorike virtuale dhe reale, lojërat e garave, simulimet e garave dhe harduerin dhe softuerin përkatës.

Në mënyrë më të detajuar, marketingu në internet faqe, shërbimet e publicitetit dhe përdorimit të kompanisë së synuar përfshijnë, për shembull, si vijon:

-krijimin dhe publikimin e lajmeve reale dhe përmbajtjeve mediatike në lidhje me sportet motorike virtuale dhe reale, lojërat e garave, simulimet e garave dhe harduerin dhe softuerin përkatës përmes portaleve të lajmeve, grupeve të internetit dhe kanaleve të ndryshme të mediave sociale;

Organizimi i garave të përditshme në internet, menaxhimi i forumeve, organizimi i modifikimeve kreative të lojërave (modave), etj.

Rejsdipartment B.V. nuk është aktive dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски